

Raporti i Vendeve mbi Terrorizmin - Shqipëria

5 Gusht 2010

Shqipëria u zotua të rrisë kontributin e saj të trupave në Afganistan, ngriu llogari bankare të lidhura me pastrimin e parave dhe financimin e terrorizmit dhe punoi vullshëm me Shtetet e Bashkuara dhe vende të tjera për të luftuar terrorizmin. Shqipëria shënoi përparim në identifikimin e pikave të dobëta në kufijtë tokësorë dhe detarë, por qeveria dhe forcat policore vazhduan të përballen me sfida në vënien në zbatim të plotë të sigurisë kufitare dhe luftimin e krimit të organizuar dhe korrupsionit.

Në 14 janar 2008, filloi gjykimi kundër Hamzeh Hamzeh Abu Rayyan, administrator i dyshuar i financuesit të terrorizmit Yassin al-Kadi, sic është përcaktuar në Rezolutën e Këshillit të Sigurisë të OKB-së UNSCR 1267. Ky shënoi të parin gjykim në Shqipëri lidhur me financimin e terrorizmit. Gjykimi vazhdoi gjatë gjithë 2009. Në një padi civile të dorëzuar nga Al-Kadi për lëshimin e aseteve të tij u hodh poshtë dhe u riparaqit disa herë. Më vonë kjo u rishikua nga gjykata më të larta për çështje të juridiksionit dhe periudhës së parashkrimit. Pasi u hodh poshtë në muajin qershor, u paraqit përsëri dhe tani po pret gjykimin në Gjykatën e Tiranës. Përveç kësaj, kompania e el-Kadit, Loxhall dorëzoi një padi në muajin prill. Ajo synonte anulimin e vendimit të Këshillit të Ministrave, si edhe dy urdhrave të Ministrisë së Financave në lidhje me administrimin e aseteve të sekuestruara të terrorizmit. Kjo padi u hodh poshtë në tetor dhe tani është në apel.

Më 12 tetor një imam lokal, Artan Kristo, u arrestua në Durrës. Kristo, i njohur gjithashtu si Muhamed Abdullah, u akuzua për “nxitje dhe propagandim publik të akteve terroriste” pas thirrjeve të dyshuara për xihad nëpërmjet forumit online në AlbSelafi.net. Më parë Kristo ishte përmendur si i dyshuar në vrasjen e Sekretarit të Përgjithshëm të Komunitetit Mysliman Shqiptar Salih Tivari, në janar të 2003. Gjykata e Durrësit vendosi ta mbajë Kriston në burg deri në fillimin e gjyqimit.

Ministria e Financave deklaroi se deri në tetor, bazuar në listën e Rezolutës UNSCR1267, kishte ngrirë asetet e gjashtë individëve dhe 14 fondacioneve dhe kompanive. Nuk pati ngrirje të reja të aseteve gjatë këtij viti nëpërmjet ligjit shqiptar për Ngrirjen e Financimit të Terrorizmit. Pavarësisht kësaj, efektiviteti i përpjekjeve të qeverisë kundër financimit të terrorizmit u minua nga mungesa e infrastrukturës së përpunimit të të dhënave dhe kapacitetit të pamjaftueshëm për të gjurmuar dhe ndjekur siç duhet rastet.